



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 705 Prot

Gjirokastër më 20. 2 2026

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Gjirokastër datë 27. 02. 2026.

Z/Znj. _____

GJIROKASTËR

Në zbatim të ligjit Nr 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 53, si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak, ju njoftoj se mbledhja e Këshillit Bashkiak do të zhvillohet në datë, 27.02.2026 ora: 12:00 pranë UNED-it, me rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i kërkesës me Nr. 1593 Prot, datë 17.02.2026 “ Kërkesë për dorëheqje” e Sekretares së Këshillit Bashkiak, Gjirokastër .
2. Zgjedhja dhe miratimi i Sekretarit të Këshillit Bashkiak Gjirokastër.
3. Miratim i procesverbaleve të mbledhjes së datës 28.01.2026 ora 12:00.
4. P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin shkurt 2026.
5. P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin shkurt 2026".
6. P/Vendim “Për vendosjen e z. Piranë Muho në shtëpinë e të moshuarve “Shpresa e Jetës”, Gjirokastër”.
7. P/Vendim “Për Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit, për znj. Donika Selimi”.
P/Vendim “Për disa ndryshime në miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për individë/familje që do të trajtohen me fonde nga Buxheti i Shtetit dhe Bashkia Gjirokastër në 2026 , pasi e kanë të vështirë të përballojnë qiranë në tregun e lirë”.
8. P/Vendim “ Për miratimin e raportit të vlersimit të të ardhurave afatmesme 2027-2029
9. P/Vendim “ Për një shtesë në VKB nr. 101, datë 22.12.2025 “ Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”.



-
10. P/Vendim “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private që do të preken pjesërisht nga zgjerimi i varrezave publike të qytetit”
11. Trajtim i kërkesave të qytetarëve.

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

